



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIK OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITI OF LIPJAN

KONTRATA

E lidhur me datën 28.08.2019 ne Lipjan ndërmjet:

Komunës se Lipjanit-Drejtorati i prokurimit të cilën e përfaqëson z. Adem Duriqi ne njërën ane (në tekstin e mëtejme) Autoriteti Kontraktues, dhe

Emri i Kontraktuesit "Detari " SH.P.K. Batllavë të cilën e përfaqëson Ismet Hasani (në anën tjetër) në tekstin e mëtejme kontraktuesi.

Titulli e kontratës: Furnizimi me material për rregullimin e dy klasëve në SHFMU Vëllezërit Frashëri -Lipjan dhe i kulmit në paralelen e ndarë në Konjuh si dhe i sportelit në QKMF - Ritenderim

me numër Identifikues 613 019 098 536

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: Furnizimi me material për rregullimin e dy klasëve në SHFMU Vëllezërit Frashëri -Lipjan dhe i kulmit në paralelen e ndarë në Konjuh si dhe i sportelit në QKMF - Ritenderim

1.2 Kontrata hynë në fuqi me nënshkrim të kontratës dhe furnizimet duhet të kryhen brenda 30 dite

1.4 Vendi i kryerjes së furnizimeve: është Shkolla Vëllezërit Frashëri në Lipjan dhe paralelja e ndarë në Konjuh dhe QKMF-ja në Lipjan

1.5 Incotermit i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë LPP-04/L-042. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra, e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi i përgjithshëm për kryerjen e Furnizimi me material për rregullimin i dy klasëve në SHFMU Vëllezërit Frashëri -Lipjan dhe i kulmit në paralelen e ndarë në Konjuh si dhe i sportelit në QKMF - Ritenderim shprehur në shifra është 3954.25€; shprehur me fjalë, tremje e nentqind e pesedhjet e kater/ Euro/e njezet e pese /cent/.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të bëhet pasi që menaxheri i kontratës të hartoj raport me shkrim për përfundimin e të gjitha furnizimeve.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore, konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, në mënyrë që të përcaktojë nëse furnizimet e kërkuara kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

9.2 Kontraktuesi duhet të garantojë që furnizimet janë të reja, të papërdorura, të modelit më të fundit. Kontraktuesi do të garantojë edhe se asnjë nga furnizimet nuk kanë asnjë defekt që shkaktohet në materialet.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c) Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e) Falimenton; f) Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 18 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në një pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqip në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Ismet Hasani	Emri:	Adem Duriqi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	29.08.2019	Data:	29.08.2019
Vula:		Vula:	

Seksioni II. Formulari i PËRSHKRIMIT TË ÇMIMIT

Furnizimi me material për rregullimin e dy klasve në Shkollën Fillore " Vllëzerit Frasheri " Lipjan

Paramasa dhe Paratlogaria - Furnizimi me material për rregullimin e dy klasve në Shkollën Fillore " Vllëzerit Frasheri " Lipjan

A

1 Punët përgatitore

1 Përgatitja e punës, bartja e mjeteve dhe materialeve të nevojshme dhe të gjitha organizimet për fillimin e punimeve.

Njësia	Sasia	Çmimi(€)	Totali(€)
Komplet	1.00	40.00	€ 40.00
Shuma 1:			€ 40.00

2 Punët Demoluese

1 Demolimi i dy mureve, nga materiali " BLOK ", me dim: 6.60m*3.10m, Pozicioni përshinë punët demoluese dhe bartjen materialit të demoluar në deponinë e përcaktuar nga organi mbikqyrës. lartësia e deponisë maksimumi 5 km

Njësia	Sasia	Çmimi(€)	Totali(€)
m ²	41.50	2.50	€ 103.75

2 Demolimi i Derrës së klasës nga materiali " Dru ", me dim: 1.20*1.10m. Pozicioni përshinë bartjen materialit të demoluar në deponinë e përcaktuar nga organi mbikqyrës. lartësia e deponisë maksimumi 5 km

Njësia	Sasia	Çmimi(€)	Totali(€)
m ²	3.50	1.50	€ 5.25

Shuma 2: € 109.00

Punët Ndërtuese		Mësimi	Sasia	Çmimi(€)	Totali(€)
1	Të bëhet ndërtimi i mureve me dim: 6.60*3.10m, 5.20m*3.10m, 2.20m* 1.10m, me material Allot Geler 230*120*10, me të gjitha anëtarësitë përputhëse.	m ²	40.00	12.00	€ 480.00
2	Të bëhet furnizimi me material dhe punimi i shtresave të gjetimit në tere sipërfaqen e mureve dhe plafonit, pozicioni përshin. Furnizimi dhe lyerja me shtresën bazë, furnizimin dhe rrafshimin me material të gatshëm MP 75 sipas gjendjes së paraqitur, kenda: e nevojshme metalike, si dhe dy shtresa gjet me sipërfaqe të lëmuar e gardime për ngjyrosje, parprakishtë sipërfaqja duhet të gëryhet pastrohet dhe lyhet me bazë, dhe rrjeta komplete	m ²	80.00	6.50	€ 520.00
3	Të bëhet furnizimi dhe ngjyrosja e mureve të brendshme me dim: 6.60*3.10m, 5.20m*3.10m, 2.20m* 1.10m, me ngjyrë yndyrë dy shtresore, zonat e frekuentimit në korridore dhe dhoma me dizajn dhe kërkesa sipas organit mbikqyrës, materiali duhet të jetë ENO.	m ²	30.00	2.50	€ 200.00
Shuma 3:				€	1,200.00

RIKAPITULLIMI I PUNËVE

1	Punët përgaditore	€	40.00
2	Punët Demoluese	€	108.75
3	Punët Ndërtuese	€	1,191.25
TOTALI ME TVSH		€	1,340.00

FURNIZIMI ME MATERIAL PËR RREGULLIMIN E KULMIT NE PARALELEN E NDAR NE SHKOLLËN FILLORE " VITËTARË FRASHËRI " NE

FURNIZIMI ME MATERIAL PËR RREGULLIMIN E KULMIT NE PARALELEN E NDAR NE SHKOLLËN FILLORE " VITËTARË FRASHËRI " NE FSHATIN KONJUH

1	Punët përgaditore				
1	Shërbimi i punësuesve (transportuesve të ndërtimit mbrenda dhe jashtë objektit) hyje daljeve në kantier, duke përfshirë edhe montimin e tabelave informuese për sigurinë në punë.	Komplet	1.00	40.00	€ 40.00
2	Përgaditja e punësuesve, bartja e mjeteve dhe materialeve të nevojshme dhe të gjitha organizimet për fillimin e punimeve.	Komplet	1.00	40.00	€ 40.00
Shuma 1:				€	80.00

2	Punët Rrënuuese				
3	Të bëhet demolimi me kujdes mbulues se kulmit nga rregullar, duke përfshirë investimet dhe ulqet horizontal dhe vertikal nga llamarinat. Pozicioni përshinë punët demoluese dhe bartjen e materialit të demoluar në disponinë e përcaktuar nga organi mbikqyrës, çmimi për m2 të sipërfaqes së kulmit	m ²	46.00	2.00	€ 92.00
11	Furnizimi dhe vendosja e foljes difuze dhe dërrasave t=24 mm mbi konstrukcionin kulmit, si bazament për vendosjen e letërës difuze dhe listelave. Llogaria në m2 të projekcionit të pjerrët	m ²	46.00	2.50	€ 115.00
12	Furnizimi dhe vendosja e konifit listelave 2/4 cm në gdo 70cm mbi dyshqypnë e dërrasave për krijimin e sipërfaqes ajruese , llogaria në m2 projekcionit i pjerrët	m ²	46.00	1.20	€ 55.20

13	Furnizimi dhe vendosja e listave 5/5 në qdë 50 cm mbi kontrollistola, llogaria në m2 projeksimi i plotët	m ²	46.00	1.20	€	55.20
14	Furnizimi dhe vendosja e llozmave të plastikuara dhe profiluar LV4 në qmim të kullarohet kulmaret, elementat lidhës, bulonët si dhe të gjitha pjesët përbyllesë	m ²	15.00	10.00	€	400.00
15	Furnizimi me material dhe punë në lulluave vertikale dhe horizontale nga llozmara të plastikuara me të gjitha elementat tjerë përbyllesë, llogaria për m ²	m ²	37.00	7.50	€	277.50
41	Furnizimi dhe montimi i konstrukcionit të kulmit komplet, nga dru i përpunuar me Mahit: 10*12, Meqmont: 15*14, Shungime: 12*12	m ³	155.00	4.00	€	620.00
Shuma 21						€ 1,374.90

RIKAPITULLIMI I PUNEVE

1 Punët përgaditore

2 Punët Reneruese

€ 80.00

€ 1,374.90

TOTALI ME TVSH € 1,754.90

Punimi i furnizimit për ndarje në koridorin e QKMF Liplan

Punimi i kornizës për ndarje në koridorin e QKMF Liplan

QKMF LIPLAN

1 Punimet shtrase

1	Profil alumin 74 mm me najza të shirit, dimensionit 180*237, një pjesë e ramir është statike dhe një pjesë e tjetër me mekanizma lëvizës, me hapje (der) 100*210, shaliteri rreshtues me dy hapje në të parë. Pjesë e sipërme statike me 2 pjesë, shami termopast 2*15*4. Punimi i derës me dim 100*210 me të gjitha mekanizmat përbyllesë.	Ndërtim	Sasia	Çmimi(€)	Total(€)
		100pë	100	850.00	€ 850.00

Shuma 11 € 850.00

RIKAPITULLIMI I PUNEVE

TOTALI ME TVSH € 850.00

TOTALI PËRGJITHSHËM 1+2+3

€ 1,754.90